



15 TETOR 2014

ECMI KOSOVO FTON PËR QETËSI NË PËRSHKALLËZIMIN E TENSIONEVE ETNIKE

Më 14 Tetor, ndeshja futbolistike në mes të Shqipërisë dhe Sërbisë është ndërprerë pas minutës së 41-të, për shkak të përleshjeve që ndodhën pasi që në fushë të futbollit u paraqit fluturakja e cila mbante një flamur jo-zyrtar Shqipëtar me shkrimin 'Autochthonous', ku shiheshin territore që nuk janë pjesë e Republikës së Shqipërisë. Pas kësaj, ka pasur përleshje në mes të lojtarëve dhe gjithashtu disa tifozëve të cilët u futën në fushë.

Pas ndeshjes, tashmë ka pasur disa tubime të të rinjëve në qendra të qyteteve. Kjo ka rezultuar me ngritje të tensioneve nëpër tërë Kosovën, sidomos në komunat Rahovec, Mitrovicë dhe Kamenicë. Në Mitrovicë, ka pasur raportime se turma kundërshtarë janë mbledhur në të dy anët e lumit Ibër. Fatmirësisht deri tani nuk ka pasur raportime për incidente të mëdha në Kosovë, edhe pse tensionet ende janë të ngritura.

Në këtë gjendje të tensioneve të ngritura, ECMI Kosovo thërret të gjithë akterët që të jenë të qetë dhe të përmbahen nga çfarëdo lloj veprimi që do të shpiente në përshkallëzim të konfliktit etnik. Është detyrë e vazhdueshme e autoriteteve relevante që të mundësojnë sigurinë e të gjithë qytetarëve.

Në lidhje me këtë Michel Platini, Kryetari i Unionit European të Federatave të Futbollit, ka deklaruar "Futbolli do të duhej t'i afroje njerëzit dhe loja jonë nuk do të duhej të përzihej me politikë të çfarëdo lloji. Këto skena të mbrëmshme në Beograd kanë qenë të pafalshme," ka thënë Platini. Kryetari i FIFA-s Sepp Blatter ka shtuar: "Futbolli nuk duhet kurrë të përdoret për porosi politike. Denoj fuqishëm atë që ka ndodhur në Beograd mbrëmë".

I udhëhequr nga shpirti sportiv, futbolli është një vegël e mirë për thyerjen e barrierave dhe për nxitjen e marrëdhënjeve rrespektuese në mes të komuniteteve. Ngjarjet sportive mund të shërbejnë si mekanizëm për të tejkaluar dallimet kombëtare në frymën e garës, dhe për të ndërtuar lidhje dhe marrëdhënje në mes të popujve.

Si një organizatë e angazhuar për qështjet e ndieshme të komuniteteve, ECMI Kosovo dëshiron të ripërsëris përkrahjen e saj të palëkundur për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe nevojën për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë etnike.

PRESS RELEASE

About ECMI Kosovo

ECMI Kosovo është organizatë kryesore jo-qeveritare e angazhuar me qështjet e minoriteteve në Kosovë, që qëllim kryesor ka zhvillimin e institucioneve gjithpërfshirëse, përfaqësuese, dhe të ndieshme ndaj komuniteteve dhe që përkrahin një Kosovë multi etnike dhe stabile. ECMI Kosovo kontribuon për zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacioneve relevante, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe përmirësimin e kapaciteteve të akterëve të shoqërisë civile dhe qeverisë për t'u ndërlidhur me njëri tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme